



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2018

**V E N D I M**

**Nr. 166, datë 27 / 8 /2018**

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 125, datë 17.08.2018, e M.K kundër F.E me profesion Avokate dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Berat në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë”, “bindjes fetare” dhe “gjendjes ekonomike”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se, në datë 27.08.2017 gjatë zhvillimit të procedurave të marrjes së të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, avokatja e caktuar kryesisht F.E është larguar dhe e ka fyer ankuesin<sup>1</sup>.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

**II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

<sup>1</sup> Referuar procesverbalit për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, datë 27.08.2017 të mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore A.Q shënon: “..... avokate F.E ..... kërkon që të largohet pasi mendon se shtetasi M.K nuk është mirë nga gjendja shëndetësore mendore”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në referim të të dhënave të paraqitura nga subjekti ankues vërehet se pretendimi i tij është bazuar në përdorimin e një fjalori fyes të Av.F.E në drejtim të M.K.

Referuar për sa më sipër Komisioneri vlerëson se përdorimi i gjuhës fyese parashikohet si vepr penale në nenin 119 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar. Në nenin 119 parashikohet se: “*Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë*” dhe palët kanë të drejtë për të kërkuar dhe shpërblimin e dëmit konform nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me ankesën e bërë nga subjekti ankues për sa i përket “fyerjes”, Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32/1, germa a), nenin 33, pikat 1, 3, 4/b, dhe 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës së M.K, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**